

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“PËR

MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR MENAXHIMIN E CILËSISË SË AJRIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është miratimi i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit, me anë të të cilit Qeveria shqiptare do të zbatojë Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe dispozitat e Ligjit nr.162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

Në përputhje me kërkesat e këtij ligji, ky plan kombëtar do të synojë realizimin e dy objektivave:

1. Përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonat ku janë tejkaluar limitet e vendosura me ligj, si dhe në zonat ku ekziston një rrisht i lartë i tejkalimit të këtyre limiteve; si dhe
2. Ruajtjen e nivelit të cilësisë së ajrit në pjesën tjetër të territorit.

Këto objektiva do të arrihen duke implementuar masa për të mos lejuar dhe për të reduktuar shkarkimet nga trafiku, burimet industriale apo burimet e shpërndara, me qëllim arritjen e përputhshmërisë së vlerave të shkarkimeve të ndotësve të ajrit me vlerat kufi të përcaktuara në ligj, por gjithashtu dhe mbajtjen ose përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonat e vendit ku arrihen standardet e cilësisë së ajrit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Përmirësimi i cilësisë së ajrit është në përputhje me prioritetet mjedisore të Programit të Qeverisë 2017-2021.

Hartimi dhe miratimi i këtij akti ligjor është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2018-2020, tremujori i katërt i 2018. Gjithashtu, hartimi i këtij projektvendimi është parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2018, katërmujori i tretë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në vitet e fundit, Qeveria shqiptare ka bërë disa investime në zonat, që direkt apo indirekt, kanë sjellë dhe reflektojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Ndër këto vlen të përmenden investimet e programuara për ripërtëritjen e transportit publik, urban dhe ekstraurban, ndërhyrjet për realizimin e parkingut, korsi për biçikleta, etj.

Edhe pse janë kryer këto investime, rezulton se në nivel kombëtar, ndotja e ajrit konsiderohet si një nga problemet kryesore mjedisore. Të dhënat që janë të disponueshme momentalisht, edhe pse të limituara, tregojnë në mënyrë të vazhdueshme shkeljet e kufijve për vlerat e ndotësve PM₁₀ dhe NO₂, dhe si pasojë nevojën për të identifikuar masat e duhura për të arritur vlerat kufi ose një ulje të shkarkimeve.

Disa nga problematikat aktuale që lidhen me fushën e cilësisë së ajrit, në vendin tonë, listohen si më poshtë:

1. Monitorimi i cilësisë së ajrit është një komponent kryesor i çdo metode efektive të menaxhimit të cilësisë së ajrit, sepse siguron një dëshmi për vendimmarrësit në menaxhimin dhe përmirësimin e mjedisit tonë. Mungesa e deritanishme e një financimi të përshtatshëm si dhe deficitet e burimeve, e limitojnë në mënyrë të ndjeshme aftësinë për të ndërmarrë të gjithë monitorimin që kërkohet për raportimin mbi shkarkimet në ajër, si dhe cilësinë e ajrit në mjedis. Programit të monitorimit të ajrit duhet t'i jepet prioriteti i duhur nga ana e institucioneve dhe Qeverisë Shqiptare.
2. Praktika e tanishme e monitorimit të cilësisë së ajrit të mjedisit, nuk është në linjë me kërkesat e BE-së. Stacionet automatike të monitorimit prodhojnë të dhëna të përqendrimeve të cilësisë së ajrit, por Siguria dhe Kontrolli i Cilësisë të të dhënave QA/QC nuk është aplikuar ndonjëherë. Sigurimi i Cilësisë është i nevojshëm, nëse të dhënat do të konsiderohen të pranueshme dhe do të përdoren për krijimin e informacionit, që duhet për menaxhimin e cilësisë së ajrit. Për të zhvilluar një sistem informacioni dhe monitorimi të mirëpajisur dhe të konsoliduar, është e nevojshme të merren sa më shpejt masat e duhura.

3. Monitorimi i shkarkimeve të substancave ndotëse nga impiantet industriale nuk mund të arrihet, për sa kohë që kontrolli i monitorimit të shkarkimeve industriale nuk kryhet sipas standardeve të duhura. Për të pasur të dhëna të besueshme të matjeve të kryera nga sektori industrial, lind nevoja për verifikimin e të dhënave të monitorimit nga inspektorati përgjegjës për mjedisin.
4. Analiza e të dhënave tregon se ka probleme të përputhshmërisë në lidhje me dy ndotësit më shqetësues për cilësinë e ajrit në Tiranë, Elbasan dhe Fier, konkretisht:
 - a. Dioksidi i azotit (NO_2) dhe oksidet e azotit (NO_x)
 - b. Materia/lënda grimcore më pak se 10 dhe 2.5 mikron në diametër, (PM_{10} dhe $\text{PM}_{2.5}$)

Nevoja për përmirësim në sektorin e ajrit, është kërkuar në raporte të ndryshme të Komisionit Evropian, duke përfshirë Raportet e Progresit të Monitorimit të KE-së, që japin gjithashtu raporte në sektorin mjedisor.

Për sa më sipër, Ministria përgjegjëse për mjedisin inicioi hartimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, si një mjet planifikimi, nëpërmjet të cilit do të vendoset në zbatim Ligji nr. 162/2014 "Mbi mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis".

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, identifikon masa afatshkurtra dhe afatmesme për tri zona të ndryshme, me nivele të ndryshme kritike të cilësisë së ajrit të mjedisit: zona A, zona B dhe zona C.

Duhet theksuar se masat e parashikuara në plan, sigurisht nuk janë shteruese dhe mund të zbatohen ose të rishikohen në lidhje me evoluimin e teknologjisë, përmirësimin e rregulloreve dhe mundësive të ndryshme; kërkimin dhe në mënyrë të veçantë, inkorporimin e një monitorimi efektiv dhe të vazhdueshëm të masave të nevojshme të mbështetura nga përditësimi i inventarit të shkarkimeve.

Zbatimi i masave të identifikuar në plan do të çojë në konsolidimin e sistemit të monitorimit, konkretisht:

- Forcimin e strukturave të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
- Krijimin e Qendrës Kombëtare të Referencës për Ajrin;
- Zbatimin e procedurave të QA/QC-it, për të dhënat e monitorimi;

- Hartimin e Inventarit Kombëtar të Shkarkimeve;
- Integrimin e sistemeve të modelimit për vlerësimin e cilësisë së ajrit.

Në terma afatgjatë, zbatimi i këtij plani do të rezultojë në një ulje të theksuar të numrit të njerëzve që vuajnë nga infeksionet respiratore, sëmundjeve të zemrës dhe kancerit të mushkërive. Synohet gjithashtu, një reduktim i përgjithshëm në ndikimet mjedisore që rezultojnë nga ndotësit në ajër (acidifikimit, procesit të eutrofikimit, reduktimit të kulturave bujqësore, degradimi i pyjeve, etj).

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, në zbatim të pikës 4, të nenit 21, të Ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar dhe të nenit 7, të Ligjit Nr 162, datë 04.12.2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk përfron ndonjë rregullore ose direktivë të veçantë të Bashkimit Evropian, por është në përputhje me kuadrin e përgjithshëm ligjor të BE-së, për fushën e Cilësisë së Ajrit, të përfruar në legjislacionin kombëtar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi, synon miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, i cili është pjesë përbërëse e vendimit dhe i bashkëlidhet atij. Plani Kombëtar përbëhet nga 7 kapituj, në vijim:

Kapitulli I, i cili paraqet një përmbledhje të strategjive dhe planeve, karakteristikat e përgjithshme të territorit dhe kuadrin rregullator.

Kapitulli II, paraqet një pasqyrë të ndotjes atmosferike, përfshirë kuadrin e shkarkimeve dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit.

Kapitulli III, Karakterizimi i zonave, përfshin përkufizimin e zonave të planit si më poshtë:

- Zona A, që përfshin aglomeratin e Tiranës dhe Elbasanit, kur janë raportuar situata më kritike për shkelje të limiteve të ligjit, dhe për sasinë e popullsisë së ekspozuar.
- Zona B, që përfshin njësitë bashkiake të Fierit, Durrësit, Vlorës, Shkodrës, Korçës, Patosit, Ballshit, Kamzës dhe Paskuqanit, e përcaktuar ose nga matje direkte, ose si rezultat i studimeve lokale, nga kapërcimi efektiv, ose risku i lartë i tejkalimit të limiteve të ndotjes nga të paktën një ndotës.
- Zona C, që përfshin territorin e mbetur të vendit, ku ndodhen komunitat që kanë një rrisht të ulët të tejkalimit të kufijve të ndotjes, të përcaktuara në ligj.

Kapitulli IV, Plani i veprimeve, që përfshin masat e zgjedhura për arritjen e objektivave të këtij plani kombëtar dhe kohën për zbatimin e tyre. Masat e zgjedhura synojnë:

1. Reduktimin e shkarkimeve të shpërndara:
 - a. reduktimin e shkarkimeve të trafikut
 - b. përmirësimin e kontrollit të cilësisë së karburantit
 - c. reduktimin e shkarkimeve nga ndërtimet dhe zhvillimi në zona urbane
 - d. reduktimin e shkarkimeve nga bujqësia
 - e. reduktimin e shkarkimeve nga drutë e zjarrit
 - f. reduktimin e shkarkimeve të shpërndara industriale (Iejet C).
2. Reduktimin e shkarkimeve nga burimet e palëvizshme.
3. Fuqizimin e kapaciteteve inspektuese dhe monitoruese.
4. Përmirësimin e ndërgjegjësimit publik.

Kapitulli V, Vlerësimi i kostos dhe shpenzimeve të zbatimit të planit.

Kapitulli VI, Strategjitë për pjesëmarrjen e publikut.

Kapitulli VII, Plani i Monitorimit dhe verifikimit, i cili ka si qëllim:

- a. vlerësimin e reduktimit efektiv të shkarkimeve në ajër, krahasuar me ato të planifikuara;
- b. efektivitetin e reduktimit të shkarkimeve, bazuar në nivelet e përqendrimit të tyre;
- c. zbatimin e objektivave të përcaktuara në strategjinë e ajrit dhe legjislacionin përkatës.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për Miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit"

Institucionet që ngarkohen në zbatimin e aktit janë:

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin;
2. Ministria e përgjegjëse për transportin;
3. Ministria përgjegjëse për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
4. Ministria përgjegjëse për Arsimin, Sportin dhe Rininë;
5. Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale;
6. Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë;
7. Ministria përgjegjëse për Financat dhe Ekonominë;
8. Inspektorati në fushën e mjedisit;
9. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);
10. Organet e Qeverisjes Qëndrore;
11. Njësitë e vetqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

- a. Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit;
- b. Drejtoria e Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të kuadrit Rregullator;
- c. Projekti (IBECA) në kuadër të IPA 2013 “Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën”.

Hartimi i dokumentit të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit ka nisur që prej vitit 2016, me asistencë të Projektit IPA 2013 “Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën” (IBECA). Gjatë hartimit të tij, dokumenti i Planit është konsultuar me institucionet e linjës, veçanërisht ministrinë përgjegjëse për fushën e transportit; ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministrinë përgjegjëse për fushën e energjisë dhe industrisë.

Proçesi i konsultimit

Në datë 1 Nëntor 2016, Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Delegacioni i Bashkimit European organizuan takim të prezantues të draftit final të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit, me përfaqësues të institucioneve qëndrore dhe lokale, që kanë si objekt të punës së tyre menaxhimin e cilësisë së ajrit.

Në datë 25 Nëntor 2016, u zhvillua dëgjesa publike. Për një periudhë 2-mujore u mbledhën komentet dhe sugjerimet nga institucionet dhe shoqëria civile, të cilat u reflektuan dhe u konsultuan disa herë deri në hartimin e draftit përfundimtar. Konsultimi me publikun i Planit Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit dhe projektvendimi që e miraton atë, u mbajt në datë 18 Prill 2017. Ky projektvendim do të konsultohet edhe me Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore me Vetëqeverisjen Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit (PKMCA) shoqërohet me efekte financiare të detajuara në kapitullin 5 të tij, “Vlerësimi i koston dhe shpenzimeve të zbatimit të planit”.

Kostoja dhe buxheti për zbatimin e PKMCA-së, është planifikuar për zbatimin e masave të parashikuara për një periudhë deri në vitin 2021.

Metodologjia e përdorur për llogaritjen e koston:

- a. Kostoja e llogaritur sipas metodës nga lart-poshtë
- b. Kostot e investimeve dhe kostot operative janë llogaritur në bazë të të dhënave të agreguara në nivel të sektorëve dhe nënsektorëve
- c. Është identifikuar shuma e shpenzimeve pa detajuar secilën masë
- d. Disa të dhëna janë të marra direkt nga qeveritë vendore ose nga sektori privat, nëpërmjet preventivëve të koston, për programet që janë duke u zbatuar dhe / ose janë zbatuar
- e. Identifikimi i burimeve të financimit (buxheti i qeverisë vendore dhe qendrore, burime të tjera).

Kostot bashkohen në një të tërë sipas 4 fushave:

- a. Reduktimi i shkarkimeve të shpërndara (nga trafiku, ndërtimet dhe zhvillimi në zona urbane);
- b. Shkarkimeve nga një burim i vetëm i identifikueshëm (stabilimentet bujqësore dhe impiantet industriale);
- c. Forcimi i kapaciteteve të inspektimit dhe monitorimit;
- d. Ndërgjegjësimi dhe trajnimi.

Ndikimi i shpenzimeve:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për Miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”

Shpenzimet që shoqërojnë zbatimin e dokumentit të PKMCA-së ndahen në:

- të drejtpërdrejta, të cilat përfshijnë ato shpenzime që ndikojnë drejtpërdrejt në kushtet e cilësisë së ajrit;
- të tërthorta, të cilat përfshijnë ato shpenzime që ndikojnë tërthorazi në kushtet e cilësisë së ajrit;
- të mundshme, të cilat përfshijnë ato shpenzime që mund të prekin kushtet e cilësisë së ajrit.

Kostoja totale e zbatimit të PKMCA-së vlerësohet të jetë rreth 318.25 milion euro.

Lloji i kostos	Fonde (milion €)	Fonde në %
Preventivi për reduktimin e shkarkimeve të automjeteve	160.8	50.5%
Preventivi për reduktimin e shkarkimeve nga ndërtimi dhe zhvillimi urban	0.5	0.2%
Preventivi për reduktimin e shkarkimeve nga bujqësia	1.1	0.3%
Preventivi për reduktimin e shkarkimeve nga impiantet industriale	138.0	43.4%
Preventivi për forcimin e kapaciteteve inspektuese dhe monitoruese	5.7	1.8%
Preventivi për rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnime	12.0	3.8%
Total	318.25	100.0%

Buxheti i alokuar për periudhën 2018-2021:

Kostot totale shpërndahen në katër zëra buxheti:

- Shpenzime për personelin
- Ekspertizë/konsulencë
- Shpenzime operative (seminare, printime, etj.)
- Kosto për investime

Alokimi i buxhetit sipas institucioneve zbatuese:

Institucioni	Në %
Bashkitë	30.08%
Ministria përgjegjëse për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural	1.86%
Ministria përgjegjëse për Mjedisin	50.72%
Ministria përgjegjëse për Transportin	18.17%
Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Energjinë	0.16%

Nga kostoja totale, vetëm një pjesë e vogël mund të financohet nga buxheti. Kostot e tjera paguhen nga ndotësit, personat fizikë, nëpërmjet pagesave të ndryshme apo investimeve direkte. Fondet publike në formën e transfertave direkte në autoritetet mjedisore, janë të nevojshme për zbatimin e planit kombëtar.

Burimet kryesore të mundshme të financimit mund të jenë:


- Tarifat e paguara nga ndotësit, makinat, kamionët, industritë etj;
- Buxhetet e shtetit apo bashkiake;
- Grantet nga instrumentet të paraanëtarësimit IPA, nga Bashkimi Evropian;
- Grantet nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF) – postanëtarësimit;
- Grantet nga donatorë të tjerë ndërkombëtarë;
- Kreditë nga institucionet ndërkombëtare të financimit (IFN);
- Kreditë nga institucionet bilaterale të financimit,

- Kreditë nga bankat komerciale;
- Detyrimet e lëshuara nga organet e qeverisjes qendrore ose lokale;
- Kapitalet private (përmes marrëveshjeve parimore ndotësi-paguan).

Për sa më sipër, ky projektvendim dërgohet për bashkëfirmosje me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe më pas për mendim në ministritë e linjës dhe në Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

MINISTRI

Ogerta MANASTIREJU



MINISTRI

Blendi KLOSI

